

PËRKRAHET INICIATIVA PËR PAJTIMIN E GJAQEVE NË SHQIPËRI

PAJTIMI I GJAQEVE DHE NDËRPRERJA E VËLLAVRASJEVE, AKT PATRIOTIK QË NDIHMON PËRPARIMIN MBARËKOMBËTAR

Gjakmarrja si fenomen dhe strategjia e parandalimit të saj ishte temë bosht në Kongresin e parë të organizuar nga Lidhja e misionarëve të Shqipërisë dhe Komitetit për Pajtim mbarëkombëtar, i cili u mbajt në Tiranë me 26 shkurt 2001. I ftuar nga organizatori në këtë tubim mori pjesë edhe z. Nikollë Shabani, u.d. i kryetarit të Bashkimit të Intelektualëve Shqiptarë në Mërgim (BISHM) i cili gjatë qëndrimit në Shqipëri pastaj edhe në Kosovë zhvilloi një sërë takimesh të rëndësishme me personalitete të shumta politike, intelektuale dhe figura të shquara të kombit.

Nisur nga gjendja e rëndë dhe trishtuese e numrit të madh të gjaqeve në Shqipëri si dhe atyre në vise tjera shqiptare, mjerisht, që në fillim duhet theksuar faktin e hidhur se ky fenomen dhe kjo plagë e vjetër mbrenda qenjtës sonë kombëtare është shëndërruar në një barre të rëndë shoqërore dhe tepër shqetsuese për përmasat e saj e cila si smundja e kancerit vazhdon t'a brejë nga mbrenda shoqërinë shqiptare shekuj më rradhë deri në ditët e sotme. Si dukuri negative dhe si e metë "gjenetike" gjakmarrja tek shqiptarët asnjëherë nuk ka pushuar, mbasë rralherë ka rënë nga intensiteti, por ajo deri me sot nuk është çrënjosur tërësisht!

Iniciativa e marrë për pajtimin e gjaqeve në Shqipëri, përkatësisht analiza mbi shkaqet e pëhapjes së gjakmarrjes ndër shqiptarët, sidomos për shkak të rritjes së saj gjatë viteve të fundit, si dhe shqyrtimi mbi strategjinë për parandalimin e saj ishin temat kryesore të cilat u shqyrtuan në Kongresin e parë të këtij lloji i organizuar nga ana e misionarëve të paqës për pajtim, bashkëjetesë dhe integrim mbrendakombëtar, na jep shpresë të madhe se kjo nisimë madhore do të kurorizohet me sukses, thotë z. N. Shabani. Për eliminimin e kësaj dukurie shkatërruese dhe tepër të dëmshme për kombin shqiptar, pajtjetër duhet të përdoren të gjitha mjetet dhe metodat pedagogjike siç është e nevojshme të ndërmerren edhe aksione konkrete në të gjitha nivelet nisur nga ato shkencore dhe deri tek puna në teren për sherimin e kësaj hemorragjie nga trupi dhe qenja jonë kombëtare. Kongresi kishte karakter gjithpërfshirës, thotë z. N. Shabani, sepse në të muarën pjesë përfaqësues të shtetit, të partive politike, klerikë, trupi diplomatik, organizma nderkombëtar, organizata joqeveritare, misionarë nga e gjithë Shqipëria, nga Kosova, M. i Zi dhe Diaspora, etj. gjë që besojmë se ate ditë u vu gurtthemeli procesit për pajtimin e gjaqeve në Shqipëri dhe parandalimin e tyre gjithandëj në trojet shqiptare. Posaçërisht brengos fakti se në disa vise të Shqipërisë siç është Malësia e Madhe ku deri me 1997 kishte vetëm 5 vrasje, që nga 1997-2001 aty ndodhën më shumë se 42 raste vrasjesh dhe ku aktualisht nga ky fenomeni mbahen të ngujuar mbi 850 fëmijë, andaj për ta çrënjosur gjakmarrjen kërkohet



mobilizim i plotë i të gjitha forcave tona politike dhe intelektuale. Në kuadër të vizitës dhe qëndrimit në Tiranë, i ftuar poashtu nga organizatorët z. N. Shabani mori pjesë edhe në Punimet e debatit intelektualë me temën: "Shqipëria në udhëkryq" i mbajtur me 17. shkurt në Pallatin e Kongreseve në Tiranë ku merrnin pjesë intelektualë dhe politikanë të shquar shqiptar, për tu takuar mëpastaj veç e veç edhe me figura të ndritshme kombëtare dhe politike të Shqipërisë siç ishte takimi me ish presidentin e Shqipërisë dhe aktualisht kryetarin e Partisë Demokratike Prof. Dr. Sali Berishën në selinë e kësaj partie në Tiranë, ku gjatë bisedës u shqyrtua roli i mërgatës shqiptare në të ardhmen si dhe detyrat që parashtrihen dhe kanë intelektualët shqiptarë në mërgim ndaj atdheut, ndaj lidhur me këto dhe çështje tjera u konstatua se mërgimtarët shqiptarë gjatë gjitha kohërave kanë luajtur rol kyç dhe shpeshherë edhe historik në rimëkëmbjen politike dhe ekonomike të vendit dhe se mërgata shqiptare sot duhet të jetë sa më unike, veçanërisht në ngritjen e frymës kombëtare tek bashkëtdhetarët, në ruajtjen e rezultateve të arritura deri më tani si dhe fakti se ajo duhet të jetë më aktive në planin e prezentimit të vlerave tona kulturore para popujve të botës. Ndërsa në takimin e zhvilluar me drejtorin e Institutit kombëtar

për diasporën dhe me udhëheqsin e Drejtoratit për arsim dhe marrëdhënie me jashtë u bisedua për mundësinë e organizimit të Javës shqiptare në Gjermani me moton: falenderojmë popullin gjerman për ndihma dhe përkrahje gjatë luftës në Kosovë, duke bërë gjatë kësaj kohe edhe prezentimi i vlerave tjera kulturore shqiptare para opinionit gjerman. Me këtë rast u shqyrtua edhe mundësia e kyçjes së nxënësve të mërgimtarëve shqiptarë nga Shqipëria në shkollat me mësim plotësues në gjuhën shqipe të cilat funksionojnë në Gjermani si dhe vende tjera të Europës. Gjithashtu z. Nikollë Shabani pati takime pune edhe me shumë figura tjera të jetës fetare, politike dhe shkencore të Shqipërisë siç ishte vizita tek shkelqësia e tij Rok Mirëdita (për t'i uruar shëndet dhe jetë të gjatë pas një infarkti të vogël që kishte patur ditë më parë), pastaj takimi me z. Emin Spahin, sekretar i përgjithshëm i Misionit të Pajtimit Mbarëkombëtar, z. Pashko Toma, përfaqësues i Malësisë së Madhe, znj. Ajrofa Hasi, sekretare e Misionit nga Shkodra, takimi me Dr. Ibrahim Milushin, kryetar i OJQ-ve për Kosovën, Caf Dervishin, përfaqësues i Postribës si dhe shumë takime tjera. Gjatë bisedave dhe takimeve që pata, thotë z. N. Shabani nga ana e të gjithë bashkëbiseduesve u vlersua lurtë roli dhe puna e



deritanishme e BISHM-it si asociacion jashtpartiak në mërgim. Gjatë qëndrimit triditësh në Kosovë z. N. Shabani vizitoj Fakultetin e Kimisë pranë Universitetit të Prishtinës meqë rast me udhëheqësit e këtij institucioni shkencor bisedoj rreth mundësisë që laboratorët pranë këtij fakulteti të ndihmohen nga firma gjermane BASF me seli në Ludwigshafen për pajisje të reja si dhe mundësia e dërgimit të studentëve shqiptarë për ushtrime praktike në Gjermani, kurse në formë të ndarë pati takime me Prof. Dr. Zekerija Canën, Dr.

Zymer Nezirin, Dr. Tahir Gjergjibifriqin, Dr. Basri Çapriqin si dhe ai me rezhiserin Emin Halili, etj. në bisedë me të cilët u shqyrtuan mundësit rreth formave konkrete të bashkëveprimimit të BISHM-it dhe institucioneve shkencore dhe arsimore të Kosovës me botën e jashtme, përkatësisht rreth koordinimit të aktiviteteve kulturore dhe arsimore në diasporë me theks të posaçëm për rolin dhe ndihmesën që mund të ofroj zhvillimit të Kosovës mërgata shqiptare në të ardhmen.

Përgatiti: Rexhep Elezaj